



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 9621 Prot.

Tiranë, më 17.07.2025

NJOFTIM

**PËR VEND PUNE
SEKRETAR I TITULLARIT
PRANË QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.32, datë 18.02.2025, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës

1. Në pozicionin e Sekretarit të Titullarit në QSHA. Ai/Ajo punon nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, si pjesë e ekipeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Sekretari punon nën drejtimin e Titullarit të QSHA-së dhe kryen të gjitha detyrat që i ngarkohen me rregulloren e brendshme të institucionit.
2. Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencat që kërkohen për këtë vend pune janë:
 - Diplomë Bachelor/ Master
 - Të ketë njohuri mbi shkrimin akademik.
 - Të ketë aftësi të të dëgjuarit, të shkrimit dhe të folurit në mënyrë efektive.
 - Të ketë aftësi në përdorimin e programeve bazë kompjuterike.
 - Të ketë aftësi në përdorimin në mënyrë efektive të dhënave informatike.
 - Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të marrë iniciativë.
 - Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe me afatë të ngushta kohore.
 - Të ketë aftësi të ndjeke dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
 - Të tregojë përkushtim ndaj misionit dhe qëllimeve të Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Paga për pozicionin është në kategorinë VII.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 31.07.2025 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto

ME URDHËR DHE POROSI

ZËVENDËSDREJTOR I PËRGJITHSHËM

Anis Thodhorjani

